



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 2502 Prot.

Tirane, 12 / 12 2023

PLANI I INTEGRITETIT PËR AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL

2024-2026

I. Hyrje

Plani i Integritetit i Autoritetit të Aviacionit Civil përfaqëson një mjet thelbësor në luftën kundër korrupsionit, duke ndihmuar institucionin në zbulimin, vlerësimin dhe parandalimin e risqeve që mund të dëmtojnë integritetin e tij. Ky plan synon të forcojë mekanizmat institucionalë për integritet dhe të implementojë masa të strukturuar kundër korrupsionit, si pjesë e reformave të administratës publike, një objektivi i rëndësishëm në strategjitë kombëtare për përmirësimin e qeverisjes dhe besueshmërisë institucionale.

Plani i Integritetit i periudhës 2024-2026 për Autoritetin e Aviacionit Civil përmban një vlerësim të detajuar të risqeve që mund të ndikojnë në integritetin e institucionit, dhe parashikon veprime të qarta për të përmirësuar funksionimin e brendshëm, transparencën dhe përgjegjshmërinë. Objektivat e tij përfshijnë rritjen e besimit të publikut dhe përmbushjen e qëllimeve strategjike të institucionit.

Rëndësia e Planit të Integritetit qëndron në aftësinë e tij për të forcuar transparencën dhe përgjegjshmërinë, duke siguruar që institucionet dhe publiku të kenë besim në veprimtarinë e Autoritetit. Përmes këtij plani, synohet krijimi i një stafi të kualifikuar, me trajnime adekuate për të ruajtur integritetin dhe profesionalizmin në çdo aspekt.

Krijimi i një sistemi të efektshëm për menaxhimin e integritetit është kyç për Autoritetin e Aviacionit Civil, duke siguruar që të gjitha veprimtaritë e tij të realizohen me standarde të larta etike dhe performancë profesionale. Angazhimi për përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre mekanizmave do të kontribuojë në ndërtimin e një sistemi të fortë dhe të besueshëm të aviacionit civil, në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare.

II. Rëndësia e Planit të Integritetit për Autoritetin e Aviacionit Civil

Qeverisja e mirë bazohet në parime si transparenca, llogaridhënia dhe qasja e hapur në informacion, të cilat janë elemente thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin institucional. Në këtë drejtim, Plani i Integritetit për Autoritetin e Aviacionit Civil ka për qëllim të forcojë integritetin dhe të përmirësojë funksionimin e tij, duke garantuar që veprimtaria e institucionit të jetë e hapur dhe e përgjegjshme.

Autoriteti i Aviacionit Civil është i ndërgjegjshëm për sfidat që lidhen me ruajtjen e integritetit dhe llogaridhënien në sektorin e aviacionit dhe është i angazhuar për të përmirësuar këto aspekte. Plani i Integritetit është hartuar për të adresuar këto sfida dhe për të ndihmuar në ngritjen e një sistemi më të fortë të menaxhimit të integritetit.

Përmes zhvillimit të masave që rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë, ky plan synon të përmirësojë funksionimin brenda Autoritetit dhe të minimizojë risqet e korrupsionit. Ky plan synon të krijojë një qeverisje më efikase dhe të besueshme në institucion, duke adresuar në mënyrë specifike çështjet kryesore.

III. Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Autoritetin e Aviacionit Civil

Plani i Integritetit për Autoritetin e Aviacionit Civil është rezultat i një analize të detajuar për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit brenda institucionit të kryera nga grupi I punës I ngritur me Urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv të AAC nr.523, date 7.9.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit për periudhën 2023-2026”. Kjo analizë u realizua gjatë periudhës Shtator– Nëntor 2023 dhe përfshiu disa fusha kyçe të aktivitetit të Autoritetit, si: (i) Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm; (ii) Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; (iii) Administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit zyrtar; (iv) Zhvillimin dhe zbatimin e politikave në aviacionin civil; (v) Përputhshmërinë me kuadrin rregullator; (vi) Transparenca dhe përfshirja e publikut.

Për zbatimin e këtij procesi u përdor metodologjia për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore. Hartimi i planit u krye nga një grup pune i përbërë nga Drejtuesit e Drejtorive në Autoritetin e Aviacionit Civil, për të siguruar një vlerësim të plotë dhe efektiv të risqeve që prekin integritetin.

IV. Identifikimi dhe analiza e risqeve të integritetit

Grupi i punës shqyrtoi kuadrin rregullator dhe dokumentacionin strategjik e operativ të Autoritetit të Aviacionit Civil për të identifikuar risqet që kërcënojnë integritetin e institucionit. Gjithashtu, u analizuan të dhënat lidhur me performancën dhe monitorimin e zbatimit të masave të integritetit në veprimtaritë e institucionit. U krye një analizë e hollësishme e këtyre risqeve dhe faktorëve që ndikojnë në to, duke marrë parasysh fusha të ndryshme të punës.

V. Hartimi dhe miratimi i planit të veprimit për menaxhimin e integritetit

Për të konsoliduar sistemin e menaxhimit të integritetit, grupi i punës hartoi një plan veprimi që përfshin masa të reja kontrolli dhe përmirësime në masat ekzistuese për menaxhimin e risqeve të integritetit. Ky plan synon të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe integritetin e institucionit.

Analiza tregoi nevojën për të forcuar kuadrin e brendshëm rregullator dhe për të zhvilluar kapacitetet e burimeve njerëzore, përmes forcimit të mekanizmave të sinjalizimit, parandalimit të konfliktit të interesit, përmirësimit të etikës, qasjes më të mirë në informacionin publik dhe angazhimit të publikut në konsultime. Plani përcakton hapat dhe aktivitetet që duhen ndjekur për të reduktuar ose eliminuar risqet e integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë për zbatimin e tyre.

VI. Metodologjia

Gjatë procesit të hartimit të Planit të Integritetit, grupi i punës vlerësoi dhe analizoi risqet e integritetit. Fillimisht, grupi i punës së Autoritetit të Aviacionit Civil u njoh me metodologjinë e vlerësimit të integritetit në institucionet qendrore. Ky proces përfshiu rishikimin e kuadrit rregullator të brendshëm, duke përfshirë urdhra, rregullore, manuale dhe dokumente të brendshme të institucionit.

Grupi i punës gjithashtu zhvilloi diskutime të fokusuara me stafin në varësi për të identifikuar çështjet që përbëjnë rrezik për integritetin në proceset e punës, praktikat dhe funksionet që mund të ekspozohen ndaj shkeljeve etike dhe profesionale.

VII. Qëllimet dhe objektivat e Planit të Integritetit

Qëllimi kryesor i Planit të Integritetit është të përmirësojë sistemin e përgjegjshmërisë, integritetit dhe transparencës në Autoritetin e Aviacionit Civil, duke rritur besimin e publikut për institucionin dhe duke forcuar mekanizmat për parandalimin e korrupsionit. Për të arritur këto synime janë përcaktuar pesë objektiva kryesore:

- Forcimi i mekanizmave të etikës dhe integritetit;
- Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore;
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Implementimi dhe zbatimi i politikave;
- Rritja e transparencës dhe përfshirjes së publikut.

VIII. Objektivat

1. Forcimi i mekanizmave të etikës dhe integritetit

Për të forcuar dhe përmirësuar mekanizmat e etikës dhe integritetit, Autoriteti do të punojë në:

- Rishikimin dhe përmirësimin e rregulloreve të brendshme që lidhen me çështje specifike të etikës dhe integritetit;
- Zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, duke u bazuar në parimet e integritetit dhe etikës profesionale.

Respektimi i standardeve etike nga punonjësit e Autoritetit është thelbësor për krijimin e një mjedisi pune që shmang sjelljet jo-etike dhe joprofesionale. Autoriteti do të vazhdojë përmirësimin e rregulloreve dhe informimin e vazhdueshëm të stafit për normat e etikës dhe integritetit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për administratën publike.

Rregullat e brendshme të rishikuara do të mbulojnë aspekte si komunikimi zyrtar, paanshmëria, disiplina e punës dhe menaxhimi efektiv i fondeve publike. Autoriteti do të sigurojë që këto parime të etikës të respektohen nga punonjësit, duke përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve dhe zbatimin e Kodit të Etikës.

Për të arritur këtë objektiv, Autoriteti do të ndjekë dy drejtime kryesore për parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve të tjera jo-etike që lidhen me integritetin:

1. Forcimi i mekanizmave institucionalë për të reduktuar risqet që lidhen me humbjen e personelit të kualifikuar, ndryshimet në menaxhim apo ligje;
2. Ndërgjegjësimi dhe trajnimi i punonjësve, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve të stafit ekzistues dhe trajnimet për punonjësit e rinj në lidhje me rregulloret që lidhen me etikën, integritetin dhe konfliktin e interesit.

Një komponent thelbësor është promovimi i mbrojtjes së sinjalizuesve, që ndihmon në krijimin e një administrate publike të paanshme dhe efektive, bazuar në parimet e integritetit. Autoriteti

do të informojë dhe ndërgjegjësojë në mënyrë të vazhdueshme stafin mbi procedurat ligjore lidhur me mbrojtjen e sinjalizuesve, duke lehtësuar raportimin e shkeljeve etike dhe profesionale.

2. Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore

Për të përmirësuar menaxhimin e burimeve njerëzore, Autoriteti i Aviacionit Civil do të vazhdojë të zbatojë me rigorozitet aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës, të cilat garantojnë një kornizë ligjore profesionale dhe të qëndrueshme. Përveç kësaj, do të ndërmerren hapa për të forcuar politikën e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke u bazuar në parimet e barazisë së mundësive, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike.

Autoriteti do të vazhdojë të punojë për të siguruar një administratë të qëndrueshme dhe për të parandaluar humbjen e stafit të kualifikuar, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe krijimin e mundësive për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

3. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit përmes forcimit të mekanizmave të monitorimit, vlerësimit të riskut dhe zbatimit të procedurave të standardizuara për menaxhimin e fondeve. Implementimi i këtyre masave siguron një përdorim më të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të të ardhurave, duke mbështetur vendimmarrjen e informuar dhe zhvillimin e qëndrueshëm institucional.

4. Implementimi dhe zbatimi i politikave

Një objektiv i rëndësishëm i këtij plani është edhe përmirësimi i implementimit të politikave në fushën e veprimtarisë së aviacionit civil si dhe ajo e Kuadrit Rregullator dhe Përputhshmërisë. Ky dokument është një ndër instrumentet që demonstrojnë vullnetin dhe angazhimin për të ngritur nivelin e integritetit institucional dhe mundësuar transparencë dhe gjithpërfshirje përgjatë hartimit, zbatimit dhe monitorimit të tyre.

5. Forcimi i Transparencës dhe Pjesëmarrjes Qytetare

Autoriteti i Aviacionit Civil do të përmirësojë mekanizmat e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare për të rritur besimin publik dhe për të siguruar shërbime cilësore. Do të zbatohen metoda proaktive për publikimin e informacionit dhe do të mbështetet përgatitja e tij në formate të hapura, duke lehtësuar përdorimin dhe analizën e të dhënave.

Në kuadër të forcimit të pjesëmarrjes qytetare, Autoriteti i Aviacionit Civil do të bashkëpunojë me ekspertë, grupet e interesit, dhe Industrinë, duke përmirësuar përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse.

IX. Plani i Veprimit

Plani i Veprimit përfshin masa për të adresuar risqet e integritetit në fushat e përgjegjësisë së Autoritetit të Aviacionit Civil, duke përshkruar aktivitetet specifike për arritjen e objektivave

të Planit të Integritetit. Zbatimi i tij shoqërohet me një proces të rregullt raportimi dhe monitorimi, që siguron ndjekjen e progresit nga personi përgjegjës brenda afateve të përcaktuara. Monitorimi vjetor vlerëson efektivitetin e masave të zbatuara, duke identifikuar nevojën për përmirësime dhe përditësime në përputhje me zhvillimet institucionale.

MIRATOHET

DREJTORI EKZEKUTIV

MAKSIM ET'HEMAJ

